



"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



Zbardhet i plotë dokumenti antishqiptar i Vaso Çubrillović, ultranacionalistit serb.
Gabimet e serbëve dhe loja me Turqinë dhe Tiranën

PLANI PËR TË ZBRAZUR KOSOVËN ME PARA DHE GJAK

*Bisedimet sekrete me Turqinë për të çuar
atje 200.000 shqiptarë,
frika prej Italisë dhe
milionat për Tiranën*

“Problemi i shqiptarëve në jetën tonë nacionale e shtetërore nuk është i tanishëm, ky problem ka luajtur një rol të madh në mesjetë, por rëndësi vendimtare mori nga fundi i shekullit të 17-të, kur masat serbe u shpërngulën në drejtim të veriut nga tokat e dikurshme të vjetra të Bashkës dhe në vend të tyre u vendosën malësorët shqiptarë. Ata gradualisht zbresin nga malet e tyre dhe vendosen në fushat pjellore të Metohisë dhe Kosovës, duke depërtuar në veri, përhapen në drejtim të Moravës jugore e perëndimore, nëpërmjet maleve të Sharit zbresin në drejtim të Pollogut e prej andej në drejtim të Vardarit. Në këtë mënyrë deri në shekullin e 19-të krijojnë trekëndëshin shqiptar, të cilët madje u futën edhe më thellë deri në Nish, duke i ndarë tokat e vjetra të Bashkës nga Maqedonia deri në Luginën e Vardarit. Kjo pykë shqiptare e populluar nga elementë arnashistë shqiptarë, në shekullin e 19 pengoi çdolloj lidhjeje të fortë kulturore, arsimore dhe ekonomike midis tokave tona veriore dhe jugore. Kjo ishte arsyeja kryesore që Serbia vetëm në vitin 1978, nëpërmjet Vranjës e Malit të Zi, Shkupit krijoi dhe mundi të mbajë lidhje të vazhdueshme me Maqedoninë dhe të ketë atje atë ndikim kultural dhe politik, ashtu siç pritej. Bullgarët, megjithëse e filluan jetën shtetërore më vonë se serbët, në fillim patën rezultate më të mira. Këtë pykë shqiptare filloi ta copëtoi Serbia që në kryengritjen e parë, duke i dëbuar banorët më veriorë shqiptarë që nga Jagorina. Pjesën tjetër të trekëndëshit shqiptar e kishte për detyrë ta shpartallonte shteti ynë i sotëm që nga viti 1918 e këtej, por ai nuk e bëri këtë. Janë disa arsye për këtë, por po përmend ato më të rëndësishmet”

Shqiptarët lindin më shumë

“Gabim themelor i funksionarëve kompetentë të asaj kohe ishte se në Ballkanin e trazuar e të përgjakur të asaj kohe, deshën që zgjidhjen e çështjeve të mëdha etnike ta zgjidhte me anë të metodave të tjera. Nuk duhet harruar se Turqia solli në Ballkan zakone të marra nga Sheriati, sipas të cilit me fitoren e luftës dhe pushtimin e një vendi, fitohet e drejta mbi jetën dhe pasurinë ndaj shtetasve të nënshtruar. Nga ata, edhe të krishterët ballkanas mësuan se fitohet me ndeshje jo vetëm pushteti dhe sundimi, por edhe shtëpia dhe pasuria. Nga viti 1912 e këtej, i kanë zgjidhur ose janë në rrugën e zgjidhjes të çështjeve të pakicave kombëtare me anë të shpërnguljes, ne kemi qëndruar në metoda të ngadalta e të plogta të kolonizimit gradual. Rezultatet e kësaj ishin negative. Rritja natyrale e shqiptarëve është më e madhe se numri i përgjithshëm i rritjes sonë natyrale bashkë me kolonistët. Nga viti 1921 deri në vitin 1931 shtesa e shqiptarëve ka qenë 68.6 ndërsa e serbëve 58,7 frymë, pra ndryshimi është 9315 banorë më shumë në favor të shqiptarëve. Duke pasur parasysh pjellorinë, rritjen e theksuar të shqiptarëve, si dhe konditat gjithnjë e më të vështira të kolonizimit sipas metodave të vjetra, ky disproporcion gjatë kohës do të bëhet gjithnjë e më i madh dhe në fund do të vihen në pikëpyetje edhe ato pak suksese kolonizuese që kemi arritur nga viti 1918 e deri më sot”.

Serbët nuk kanë plan shtetëror për marrjen e Kosovës

“Edhe vet mënyra e kryerjes së kolonizimit sipas metodës nuk u zbatua siç duhet. Më e rëndësishmja është se për një problem të tillë, me kaq rëndësi, nuk ekziston një plan i caktuar shtetëror, të cilit duhet t’i përmbahej e zbatonte çdo regjim. Punohej copë-copë, sot për nesër, çdo ministër prishte të vjetrën atë të paraardhësit të tij, por duke mos krijuar edhe ai vetë diçka solide. Ligjet e rregullat ndryshoheshin, por edhe ashtu të dobëta nuk viheshin në jetë. Disa, sidomos deputetët, po të ishin nga vise të vjetra, kur nuk mund të fitonin mandatin nga ajo kombësia e tyre, shkonin poshtë në jug dhe kërkonin mandatin nga kombësia e tyre, duke rrezikuar kështu interesat e mëdha nacionale e shtetërore. Aparati i kolonizimit ishte mjaft i shtrenjtë, i fryrë dhe i mbushur me njerëz jo vetëm të papërgatitur nga ana profesionale, por edhe shpesh mendjemëdhenj e të paaftë, kështu që puna e tyre përbënte një pikëpyetje në vetvete”.

Gabimi me kolonët malazezë

“Edhe disa mijëra familje që u vendosën pas luftës e këtej nuk zunë rrënjë në vendin ku u vendosën. Në Kosovë pati sukses më shumë, sidomos në luginën e Llapit, ku topiçanët depërtuan nga veriu në jug. Këtu janë kolonitë më të vjetra të përziera me elementë nga krahinat tona të ndryshme, ndërsa në Drenicë e Metohi, si krahina më të qëndrueshme, nuk patëm sukses. Asnjëherë nuk duhet bërë kolonizimi vetëm me malazezë. Jo për shkak se ata janë element i keq kolonizues, por për arsye të prirjeve të tyre për blegtori, sepse kjo ka të bëjë vetëm me gjeneratën e parë. Gjenerata e dytë është krejt ndryshe, më aktive dhe më praktike. Fshati Petrovë në Miroç, sipër Danubit, që është i banuar vetëm nga malazezë, është fshati më i përparuar në Krajine. Dhe sot në Serbi, mund të gjenden me mijëra familje të përparuara, veçanërisht në Toplicë dhe Kosanicë, që janë malazezë të gjeneratës së parë dhe u përzien me elementë përparimtarë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Metohinë, ku mbështetja direkt në vatrën e vjetër bënë të mundur ruajtjen e zakoneve dhe të shprehive të vjetra. Për këtë arsye ka pasur kaq pak sukses kolonizimi në të gjithë Metohinë. Duhet pranuar se të gjitha kolonitë kanë qenë të vendosura mjaft keq, nëpër toka kodrinore, me driza dhe jo pjellore, si dhe gati krejtësisht të pafurnizuar me mjete të domosdoshme bujqësore. Ndërkohë ato duheshin ndihmuar shumë më tepër, pasi janë koloni me elementin më të varfër malazez”.

Shqiptarët mbajtën me fanatizëm tokat më të mira

“Pa dyshim, shkak i kryesor i mospërfitimit të kolonizimit tonë në ato vise ishte se tokat më të mira mbetën në duar të shqiptarëve. E vetmie mënyrë e mundshme për kolonizimin tonë në masë, në ato vite, ka qenë marrja e tokave shqiptare. Mbas luftës, në kohën e rebelimit dhe të aksioneve të komitëve, do të dëboheshin lehtë një pjesë shqiptarësh për në Shqipëri, duke uzurpuar pronat e tyre. Përsëri kthehemi te gabimi ynë trashanik, te konceptet tona pas luftës, mbi të drejtën e posedimit të tokës. Në vend që të shfrytëzonim konceptin e vet shqiptarëve, lidhur me pronësinë e tyre mbi tokën e uzurpuar dikur, gjë që rrallëkush prej tyre ka pasur tapinë e Turqisë, dhe këtë mund ta ketë pasur vetëm për tokën e blerë, neve në dëmin tonë nacional e shtetëror jo vetëm që i lejuam të gjitha ato uzurpime, dhe aq më keq që i mësuam shqiptarët me idetë e Evropës Perëndimore, mbi posedimin e pronës private. Në këtë mënyrë ua dhamë vetë këtë armë në dorë, me të cilën dhe mund të mbrohen, t’i

mbajnë tokat më të mira dhe të na e bëjnë të pamundur nacionalizimin në favor tonë të viseve më të rëndësishme. Nga e gjithë kjo që u tha më lart del se metoda e përgjithshme e deritanishme e politikës sonë të kolonizimit në jug, nuk kanë dhënë ato rezultate, të cilat, në të vërtetë, duhet t'i arrinim dhe që tani qëndronin përpara nesh si një detyrë e madhe dhe emergjente shtetërore. Këto metoda nuk i kemi kritikuar për hir të kritikës, por që në bazë të eksperiencës së mëparshme të gjejmë rrugët e drejta për zgjidhjen e kësaj çështjeje madhore”.

Shqiptarët të ndihmuar nga imperializmi italian për çështjen e tyre

“Ky bllok shqiptarësh përreth maleve të Sharrit është i një rëndësie të madhe nacionalisto-shtetërore e strategjike për shtetin tonë. Blloku shqiptar nga ana ushtarako-strategjike, zë një pozitë nga më të rëndësishmet në vendin tonë, vendshpërndarja e lumenjve ballkanikë në drejtim të Adriatikut, Detit të Zi e të Egjeut. Mbajtja e kësaj pozite strategjike vendos në një masë të mirë fatin e Ballkanit qendror, sidomos fatin e komunikacionit të rëndësishëm ballkanik Moravë-Vardar. Nuk janë të rastit zhvillimi i luftërave shpesh herë vendimtare për fatin e Ballkanit, prandaj është detyrë imperative për të gjithë ne që këto pozita, kaq të rëndësishme strategjike, të mos i lëshojmë të na i mbajë në duar elementi i huaj dhe armik. Aq më tepër, përderisa ky element ka mbështetjen e shtetit nacional të së njëjtës gjini. Ai sot është i pafuqishëm, por edhe si i tillë është bërë bazë e imperializmit italian, nëpërmjet të cilit synon të depërtojë deri në zemër të shtetit tonë. Kundër këtij depërtimi, mjet më i sigurt është elementi ynë, i cili do të dojë e do të dijë të mbrojë pronën dhe shtetin e vet. Mandej, përveç këtij blloku prej 18 rrethesh, shqiptarët dhe pakicat e tjera nacionale në krahinat jugore jetojnë të shpërndarë dhe prandaj nuk janë aq të rrezikshëm për jetën tonë nacionale dhe shtetërore. Kolonizimi nga veriu duhet pakësuar në krahinat e kolonizuara me maqedonas. Në këto krahina edhe tokë ka pak, janë krahina pasive dhe për këtë ata janë të ndjeshëm nga prurja e kolonëve nga veriu. Aq më tepër në këto veprime ata shikojnë me mosbesim te ne. Është e vërtetë se ai kolonizim i pakët më tepër dëmton sesa sjell dobi. Nëse do të dërgohen poshtë, në jug të Malit të Zi të Shkupit, duhen çuar Vranjët, Leskovçanët, që afrojnë me të në mentalitet e kulturë, dhe në asnjë mënyrë Dinarikët me temperamentin e tyre të papërmbajtur, të ashpër e të padurueshëm, mbasi te vendasit, me elementë të tillë shkaktohen të këqija dhe gjak. Problemi i Sanxhakut të Novi-Pazarit, po zgjidhet vetvetiu dhe nuk lot atë rol për jetën tonë shtetërore, të cilin e luajti deri në vitin 1912. Vetëm po të përmendim që me shpërnguljen e shqiptarëve ndërpritet lidhje e fundit ndërmjet myslimanëve tanë në Bosnje dhe të Novi-Pazarit, si dhe me botën tjetër myslimane. Fakti që ata shndërrohen në pakicë fetare, e vetmja pakicë në Ballkan, do të shpejtojë nacionalizimin e tyre. Kohët e fundit Mali i Zi u bë problem i rëndë, vend i varfër dhe nuk është në gjendje të ushqejë popullsinë e vet, por me gjithë shpërnguljet, ai nga viti 1912 deri në vitin 1931 u shtua 16 për qind”.

Zgjidhja: vetëm dhuna

“Si përfundim, shqiptarët është e pamundur të zbrazen vetëm me anë të kolonizimit gradual, ky është i vetmi popull që arriti gjatë një mijë vjeçarit të fundit jo vetëm të mbahet në bërthamën e shtetit tonë, Rashkës e Zebres, por dhe të na sjellin dëme duke shtyrë kufijtë tanë drejt veriut dhe lindjes. Shqiptarët na shtynë nga krahina e Shkodrës, nga Metohia dhe Kosova. E vetmja mënyrë dhe i vetmi mjet është forca brutale e një pushteti të organizuar shtetëror. Qysh nga viti 1912 e këtej nuk kemi pasur sukses në luftë me ta, faji për këtë është i yni, mbasi këtë pushtet nuk e kemi shfrytëzuar si duhet. Për ndonjë nacionalizëm të tyre në dobi tonë as që mund të flitet, por, përkundrazi, duke u mbështetur te Shqipëria, zgjohet ndjenja e tyre

nacionale, e nëse nuk do t'i mbarojmë llogaritë me ta, ose ja lëmë këtë kohës, për 20 apo 30 vjet do të kemi një irredentizëm të tmerrshëm, gjurmët e të cilit tashmë duken, dhe në mënyrë të paevitueshme do të vihen në pikëpyetje të gjitha posedimet tona në Jug”.

Të bindet Tirana me para për të pranuar kosovarët

“Të nisemi nga pikëpamja se ngushtimi gradual i shqiptarëve me anë të kolonizimit tonë të ngadalshëm është i paefektshëm. Atëherë na mbetet e vetmja rrugë, shpërngulja në masë. Në këtë rast kemi parasysh dy shtete Shqipërinë dhe Turqinë. Shqipëria me popullsi të rrallë, me moçale të shumta ende të pathara, lugina shterpë të pasistemuara, do të ishte në gjendje të pranojë disa mijëra shqiptarë nga vendi ynë. Turqia moderne, me sipërfaqe të mëdha toke në Azinë e Vogël dhe Kurdistan, akoma të pabanuara dhe të papunuara krijojnë mundësi të pakufizuara për kolonira të brendshme. Më parë theksojmë se nuk duhet të kufizohemi vetëm në përçapjet diplomatike me Ankaranë, por duhet të përdoren të gjitha mjetet për ta bindur Tiranën që të pranojë një pjesë të të shpërngulurve. Besoj se kjo punë në Tiranë do të ecë me vështirësi, pasi Italia do ta pengojë këtë punë, por të hollat luajnë rol të madh në Tiranë. Turqia është dakord që, fillimisht, të pranojë 200 mijë të shpërngulurit shqiptarë, duke cilësuar që këta të jenë shqiptarë dhe kjo për ne është gjë e mirë dhe forma më e pranuar. Dëshirën e Turqisë duhet ta pranojmë me të dyja duart dhe ta shfrytëzojmë sa më parë konventën për shpërngulje. Gjatë shpërnguljes duhet studiuar konventa, të cilën ajo, vitet e fundit, e ka përfunduar për të tilla çështje me Greqinë, Rumaninë dhe Bullgarinë. Duhet pasur kujdes në dy gjëra: nga ajo të kërkohet që të pranohet një kuotë sa më e madhe, ndërsa nga ana financiare i duhet dhe një ndihmë sa më e madhe, sidomos për rregullimin e çështjes së transportimit sa më të shpejtë. Padyshim, që ky problem do të ngjallë sadopak shqetësime ndërkombëtare, gjë që është e paevitueshme në këto raste. Në rastin konkret duhet të punohet për përfundimin e një konvente me ta për këtë problem. Nëse nuk do t'ia arrijmë problemit, të paktën për ato shpërngulje të shqiptarëve drejt Turqisë, të heshtin. E rikujtojmë edhe një herë se mjeshtëria e veprimit në Tiranë dhe të hollat e përdorura në mënyrë racionale, do të mund të luanin rol vendimtar në këtë çështje. Shpërngulja e disa qindra-mijë shqiptarëve nuk do të çojë në shpërthimin e një lufte botërore. Vetëm organet kompetente duhet të dinë se çfarë është e nevojshme dhe të luftohet me këmbëngulje për realizimin e planit, duke mos u trembur nga pengesat e mundshme ndërkombëtare. Italia, padyshim, do të nxjerrë pengesa të shumta, por ajo sot për sot është tepër e zënë me problemet e saj me Abisininë dhe Austrinë, nuk besoj se do të shkojë aq larg në këmbënguljen e saj. Me thënë të drejtën, rreziku më i madh është po të përziën në këtë çështje aleatët tanë të mëdhenj, Anglia dhe Franca, në këtë rast atyre u duhet përgjigjur me gjakftohtësi e vendosmëri, pasi është në interes të tyre sigurimi i linjës Moravë-Vardar, gjë që u pa fare mirë edhe gjatë luftës së fundit dhe kjo do të jetë më e sigurt për ne dhe për ata, vetëm kur ne të sundojmë plotësisht këto vise rreth malit të Sharit dhe në Kosovë”.

Mënyra e shpërnguljes: feja dhe bërja e jetës e padurueshme nga shteti

“Tashmë dihet se është më efikase mënyra e shpërnguljes në masë e shqiptarëve nga trekëndëshi i tyre. E që të arrihet një shpërngulje në masë si kusht i parë është që të krijohet një psikoze e përshtatshme, e cila mund të krijohet në shumë mënyra. Dihet që masa myslimane shumë shpejt i nënshtrohet influencimit, sidomos fesë, besojnë në të shpejt e me fanatizëm, prandaj në radhë të parë shpërnguljen e tyre ta bëjnë vetë drejtuesit shpirtërorë të tyre dhe njerëzit me influencë, me para ose me shtrëngim. Duhet të gjenden sa më parë agjitorët, të cilët do të propagandojnë për

shpërnguljen, mirë do të ishte sikur të na i jepte Turqia këta. Ata duhet të përshkruajnë bukurinë e viseve në Turqi, jetesën e lehtë dhe të këndshme atje, të ndezin fanatizëm fetar dhe t'u zgjojnë krenarinë shtetërore turke. Mjet tjetër do të ishte edhe shtrëngimi nga aparati shtetëror. Ai duhet të shfrytëzojë ligjet deri në fund, në mënyrë që t'ua bëjë sa më të padurueshëm qëndrimin shqiptarëve të ne. Duhet të aplikohen gjobat, burgimet, aplikimi në mënyrë të pamëshirshme i të gjitha dispozitave policore, si dënimi e kontrabandës, prerjen e pyjeve, përvetësime, lëshimin e qenve në oborret e shtëpive. Të detyrohen sa më shumë njerëz që të punojnë angari dhe të merret çdo masë tjetër, që mund të aplikojë një polici me përvojë si masa ekonomike, mosnjohja e tapive të vjetra, duhet të vendosen taksa të pamëshirshme, detyrimi i shlyerjeve të të gjitha borxheve private e publike, e kullotave komunare dhe publike. Duet të zhvishen shqiptarët nga koncesionet, heqja e lejeve afariste për kafenë, dyqane tregtare, mos të lejohen shqiptarët të marrin leje për krijim monopolesh, pushimi nga puna shtetërore, private e të tjera mënyrë shtrënguese, për të shpejtuar procesin e shpërnguljes...”.

Si do bëheshin sllave vajzat dhe kërkesa për 600 milionë dinarë për të përzënë 40 mijë familje

“Duhet të zbatohen me dhunë të gjitha dispozitat, edhe në shtëpi, që duhet të fillojnë që me prishjen e mureve rrethuese të shtëpive, zbatimin rigoroz të masave veterinare, që do të pengojnë nxjerrjen e bagëtive të tyre në treg. Gjithashtu, duhet aplikuar edhe masa praktike me efikasitet. Kur është fjala për fenë, shqiptarët janë shumë të ndjeshëm ndaj saj, kështu që edhe duhet të preken. Kjo mund të arrihet nëpërmjet keqtrajtimit të klerikëve, me prishjen e varrezave, me ndalimin e poligamisë dhe, sidomos, me zbatimin e pamëshirshëm të ligjit për dërgimin e detyruar të vajzave në shkollat fillore, kudo që të ndodhen ato. Edhe iniciativa private mund të ndihmojë shumë në këtë drejtim. Kolonistëve tanë, në rast nevojë, duhet t'u shpërndajmë armë. Medoemos, duhet lëshuar një valë malazezësh nga bjeshkët që të shkëmbejnë konflikte të gjera me shqiptarët në Metohi. Ky konflikt duhet të përgatitet nga njerëz të besuar, të nxitet dhe t'i jepet hov, po nga këta, në mënyrë që të krijohet një psikozë e vërtetë, sikur shqiptarët kanë ngritur krye, dhe nga ana tjetër, krejt ngjarjet duhet të paraqiten me keqardhje si konflikt vëllezërisht dhe fisesh, në rast nevojë, mund t'i jepet karakter ekonomik. Në fund të fundit, mund të nxiten edhe turbullira lokale, që do të shtypen në mënyrë të përgjakshme me mjetet më efikase, por jo aq me ushtri, se sa me kolonistë, me fise malazezësh dhe me çetnikë. Mbetet edhe një mjet, të cilin Serbia e ka përdorur në vitin 1973, duke djegur në masë fshatra dhe blloqe qytetesh shqiptarë.

Harta e shpërnguljeve të shqiptarëve

Rrethet që duhen të shpërngulen janë: Dibra e Sipërme, Pollogu i Poshtëm e i Sipërm, Mali i Sharit, Drenica, Peja, Istogu, Vuçiterna, Stavica, Llabi, Graçanica, Nerodimja, Gjakova, Podgori, Gora, Podrimja, Gilani dhe Kaçaniku. Nga këto rrethe, që përbëjnë pykën shqiptare, për ne, aktualisht, më të rëndësishme janë: Peja, Gjakova, Podrimja, Gora, Podgori, Shari, Istogu dhe Drenica, në veri këto të Malit të Sharit. Për mendimin tim, këto janë rrethe kufitare që duhet të shpërngulen me çdo kusht. Rrethet në thellësi si: Kaçaniku, Gilani, Nerodimes, Graçanicës, Llabit, Vuçiternës, mundësisht, duhen dobësuar, sidomos, ai i Kaçanikut dhe i Llabit, ndërsa të tjerët duhet të kolonizohen gradualisht e sistematikisht. Kjo duhet të realizohet gjatë dhjetë vjetëve. Gjatë shpërnguljeve të para duhen pasur parasysh shumë gjëra, por më të rëndësishmet janë: në radhë të parë duhet të bëhet shpërngulja e fshatrave dhe pastaj e qyteteve. Fshatrat janë më kompaktë, prandaj paraqesin

rrezik. Nuk duhen shpërngulur vetëm të varfrit, por edhe njerëzit e pasur dhe të mesëm, të cilët përbëjnë kolonën vertebrale të çdo populli. Të varfrit, duke qenë pa mbështetje ekonomike dhe të pavarur nga bashkatdhetarët, shpërngulen shpejt. Kjo është një çështje me shumë rëndësi, pasi është një nga shkaqet kryesore për mosesuksesin sa duhet të kolonizimit tonë në Jug, sepse i shpërngulëm të varfrit, kurse të pasurit mbetën dhe qëndrojnë gjithnjë në të njëjtën gjendje, ku si rezultat, shumë pak tokë u përfitua për vendosjen e kolonëve tanë. Gjatë përgatitjes së psikozës për shpërngulje, duhet të bëhet çmos që të largohen fshatra të tërë, në fund të fundit, familje të tëra. Duhet të kihet parasysh që të mos mbeten këtu, pjesë familjesh të shpërngulura. Shteti ynë duhet të shpenzojë miliona jo për t'ua lehtësuar jetën shqiptarëve, por për t'i hequr qafe sa të jetë e mundur më parë. Për këtë duhet penguar, pa tjetër, blerja e pasurisë së shqiptarëve që shpërngulen, nga ata që mbeten te ne. Bashkë me këtë duhet kombinuar edhe shpërngulja e individëve me atë të fshatrave të tërë, kjo, nëse dëshirojmë që të kemi lehtësira gjatë procesit të shpërnguljes. Sapo të bien dakord për t'u shpërngulur, duhet t'u jepet ndihmë e gjithanshme. T'u paguhet menjëherë pasuria dhe të shkëputen menjëherë nga ana administrative, dokumentet e udhëtimit t'u jepen pa asnjë farë formaliteti. Të ndihmohen për të shkuar në stacionin më të parë hekurudhor, duke ju vënë në dispozicion trena deri në Selanik dhe prej aty të çohen menjëherë me vapor në Azi. Ka shumë rëndësi që udhëtimi të jetë i rehatshëm dhe pa shpenzime. Udhëtimin me tren, mundësisht, ta bëjnë pa pagesë, njëkohësisht të ndihmohen edhe me ushqime, pasi nga kjo varet shume shpërngulja në masë ose jo. Frika e vështirësive të udhëtimit është pengesa kryesore e lëvizjes së tyre. Për këtë arsye është e domosdoshme që të eliminohen vështirësitë, duke i zgjidhur shpejt e në mënyrë energjike të gjitha punët rreth udhëtimit të tyre. Duhet pasur kujdes që të shpërngulurit të kenë sa më pak probleme gjatë udhëtimit, pasi njerëzit e thjeshtë orientohen me vështirësi, prandaj është e nevojshme që t'u mësohet sistemi i transportit të punëtorëve nëpërmjet agjencive të mëdha. I shpërnguluri duhet të kalojë nga dora në dorë, duke mos e ndjerë peshën e kësaj lëvizjeje. Vetëm në këtë mënyrë mund të krijohet lumi i shqiptarëve të shpërngulur".

Popullarizimi i krahinave të shpërngulura

"Problemi i vendosjes së kolonëve në vendet e boshatisura, nuk është më i vogël se largimi i shqiptarëve. Pyetja e parë që shtrohet është se kush duhet të vendoset atje? Më e natyrshme është që atje të vendoset elementi ynë nga krahinat pasive, në radhë të parë malazez, hercegovinas, liçanas dhe kraishnicas. Malazezët janë më të përshtatshëm për shumë arsye, pasi Metohia, Drenica dhe Kosova, janë vendet më të natyrshme ku vërshojnë nga malet e tyre të varfra. Shtimi i popullsisë në Mal të Zi ka sjellë varfëri, gjë e cila ka shkaktuar lëvizje të vazhdueshme social-politike, kohët e fundit, jo të favorshme këto për pushtetin tonë dhe mjaft të rrezikshme, përsa i përket rendit e qetësisë në të ardhmen. Nuk na intereson që tyre t'u japim misër e pensione. Për këtë, e vetmja zgjidhje është çuarja e tyre në krahinat pjellore të Metohisë, Drenicës e Kosovës, sepse afrohen në mentalitet e temperament me shqiptarët. Malazezët janë arma më e përshtatshme për mposhtjen dhe largimin e shqiptarëve. Në radhë të parë, ata duhen përdorur në viset shqiptare në veri të Malit të Sharit, por, krahas tyre, duhen kolonizuar edhe me një sasi liçanas, kraishnicas, serbësh, çaçaka, uzhiçanash dhe topliçanas. Kjo është e nevojshme për të krijuar tek ata shprehite e punës dhe të organizimit, për të thyer psikologjinë e tyre nomade-kolektive prej malësorësh, me qëllim që të neutralizojmë këtë psikologji me anë të përzierjes dhe martesave nga vise të ndryshme dinarike. Kështu do të arrihet të krijohet një tip i ri malazesi, më pak lokal dhe më tepër i ngjashëm me serbin. Kurbetlinjve serbojugorë, në jug të malit të Sharit, duhet t'u krijojmë kondita të

përshtatshme, në mënyrë që të fusin në dorë toka pjellore. Ky do të jetë një kontigjent i ndershëm e punëtor, i cili do t'i jetë mirënjohës për gjithë jetën këtij shteti, në rast se do të krijojmë kushte për jetën e tyre në fshat. Përgjithësisht, fshati i serbëve të jugut ka të drejtë të kërkojë nga ne më shumë përkujdes dhe preokupacion nga sa po tregojmë sot. Kolonizimi me anë të këtyre varfanjakëve në Pollog të Sipërm e të Poshtëm, në Dibër si dhe dhënia e kullotave këtyre, në vend të shqiptarëve, do të bëjë të kuptohet se ky është shtet i tyre si dhe do të dinte t'i mbronte kufijtë me gjak. Pranë tyre, në jug të malit Shar dhe të Malit të Zi të Shkupit, mund të kolonizohet me vranjanët, leskovçanët, pirotasit dhe vllastiçanët, sidomos ata të fshatrave malorë pasivë. E përsërisim edhe njëherë se dinariket nuk duhen lejuar në jug të linjës së Malit të Zi të Shkupit dhe Malit të Sharit. Gjatë kolonizimit të fshatrave të lëna nga shqiptarët, duhet evituar ngadalësia burokratike. Kryesorja, në radhë të parë, është dhënia e menjëhershme e tapive kolonistëve, për pronat ku do të vendosen, sepse një nga shkaqet kryesore të mospësuksit të kolonizimit tonë të sotëm, ka qenë, pikërisht kjo, sepse kolonialisti nuk e ka ndierë veten të sigurt në pronën ku është vendosur. Atij nuk i është dhënë tapia menjëherë dhe kështu ishte i ekspozuar përpara poshtërsirave të shumta të nëpunësve dhe politikanëve të pandërgjegjshëm. Fshatari e ndjen veten të sigurt në pronën që posedon, vetëm atëherë kur e di se askush nuk mund ta lëvizë nga atje, prandaj, duhet t'i jepet menjëherë kjo garanci. Pra, kolonistëve u duhen krijuar të gjitha kushtet e jetesës për disa vjet, nëse dëshirojmë që ata të mbeten atje. Pa mëshirë duhet të shuajmë çdo spekulim që bëhet me pronat dhe shtëpitë e shqiptarëve të shpërngulur. Shteti duhet të ruajë për vete të drejtën e pakufizuar për zotërimin e pasurisë së tundshme e të patundshme të të shpërngulurve, madje, menjëherë pas largimit të tyre, të vendosë aty kolonistët e vet. Kjo duhet bërë pasi rrallë herë ka ndodhur që të shpërngulet menjëherë gjithë fshti. Në këto fshatra, në radhë të parë duhet të vendosen malazezë, si njerëz arrogantë, të rrëmbyer, të paarsyeshëm dhe të papërmbytur, të cilët, me silljet e tyre do t'i detyrojnë shqiptarët e mbetur të shpërngulen, e mandej, të sillen në këtë vend kolonistë nga vendet të tjera. Jo më pak i rëndësishëm është për ne edhe problemi i Vojvodinës, sidomos trekëndëshi hungarez në Baçka Senta Kulla, Baçka-Topolla. Të shkatërrosh atë në Vojvodinë, do të thotë, njësoj sikur të shkatërrosh bllokun në shqiptar rreth Malit të Sharit".

Kolonizimi: ushtria serbe të merret me organizimin e tij

"Një problem i rëndësishëm së veçantë për zgjidhjen e këtij problemi mbetet ekzistenca e një aparati, që do të drejtojë të gjitha punët. Si rezultat i punës së keqe të aparatit të deritanishëm të politikës sonë të kolonizimit, qëndron një pjesë e mirë e mospësukseseve tona të deritanishme. E që të evitohet kjo në të ardhmen, duhet bërë riorganizimi. Asnjë çështje tjetër nuk kërkon aq vazhdimësi e kujdes për t'u kryer, sesa kolonizimi. Kemi thënë se një nga shkaqet e mospësuksit tonë në kolonizimin në jug dhe në veri, është puna josistematike e drejtimit dhe ndryshimi i politikës sipas ndryshimit të qeverive. Që të evitohet kjo në të ardhmen, kolonizimi i duhet besuar Shtabit të Përgjithshëm, pasi ushtria jonë është e interesuar që në kufijtë tanë, sidomos në sektorë delikatë, të vendosë elementë të vetë. Për këtë do të bëjmë çmos që të sigurojmë kufijtë me një kolonizim sa më të fortë. Shtabi i Përgjithshëm si institucion primar i mbrojtjes së interesave kombëtare, mund t'i japë shumë gjithë politikës sonë të kolonizimit. Tërë kompleksin e punë, Shtabi i Përgjithshëm do të mund ta drejtonte nëpërmjet një Këshilli Shtetëror për kolonizimin. Ky këshill do të ishte krejtësisht autonom, duke qenë plotësisht nën urdhrat e shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe do të kishte nën varësi të gjitha organizmat e kolonizimit tonë. Në këtë këshill duhet të hyjnë përfaqësues të disa ministrive të interesuara, shoqatave nacionaliste, organizatave teknike dhe institucioneve shkencore. Është e nevojshme

lidhja organike në politikën tonë të kolonizimit ndërmjet pushtetit shtetëror, iniciativave private dhe institucioneve shkencore. Iniciativa private mund të veprojë në shumë drejtime si, Mbrojtja Popullore, Sokollashat dhe shoqatat çetnike. E para do të jetë ushtria civile e ngritur nga shteti, sokollashat do të jenë çeta terroriste të padeklaruara, të armatosura dhe udhëhequra nga shteti për luftë kundër shqiptarëve, ndërsa çetnikët, çeta kriminelësh civilë të armatosur nga shteti për të kryer krime të vazhdueshme kundër shqiptarëve. Edhe shoqatat kulturore si: "Prosfeta" në Sarajevë, "Matica Srepska" në Novi Sad, "Sv. Sava" në Beograd e të tjera si këto, kanë detyrat e tyre lidhur me këtë çështje. Duhet të krijohet një institut kolonizimi, detyra e të cilit të jetë marrja me studimin e kësaj çështjeje. Pushteti shtetëror duhet të veçojë tashmë nga disa ministri dhe të tjera institucione që janë marrë, deri tani, me këtë problem organizma dhe të krijojë një institucion të veçantë, "Inspektoriatin e kolonizimit". Vetë teknikën organizative të shpërnguljes së shqiptarëve dhe vendosjen e kolonistëve tanë, do të përpunojë instituti shtetëror dhe instituti për kolonizim. Ndoshta, nuk do të ishte keq që përveç këtyre, të ishte edhe një organizatë private dhe të mbështetej në shoqatat ekzistuese dhe të kishte si detyrë që me vetë iniciativat private, të merrej me zbatimin e politikës sonë të kolonizimit. Më mirë do të ishte sikur përsipër këtë punë ta merrte lidhja e shoqërive tona kulturore-arsimore. Ajo do të interesohej për koordinimin e punës së shoqërive private me punën shtetërore të kolonizimit dhe do të shërbente si ndërmjetës midis tyre dhe Institutit për Kolonizim".

Mjetet financiare, 600 milionë dinarë për shpërnguljen e 40 mijë familjeve

"Sa herë që është kritikuar politika jonë e kolonizimit për mossuksese, mbrojtësit e saj janë ankuar për mjetet e pakta financiare që ka vënë shteti në dispozicion për të kryer këtë punë. Nuk e mohoj se nuk është kështu deri në një farë mase, por duhet thënë se më tepër është shpenzuar për mbajtjen e këtij aparati dhe për një punë joracionale, sesa për vetë kolonizimin. Megjithatë, nëse shteti nuk ka dhënë aq sa duhet, duhet pranuar se çdo shtet ka interesat e tij primare dhe sekondare. Në interesat primare futet edhe detyra e shtetit që të sigurojë vetveten në krahinat e pasigurta nacionale, të kolonizuara me elementin e vet. Para së gjithash, le të llogarisim se sa do t'i kushtonte shtetit tonë shpërngulja e 200 mijë shqiptarëve dhe vendosja e një numri po aq kolonës në ato vende. Shpërngulja e rreth 40 mijë familjeve, duke marrë mesataren që një prej tyre përbëhet prej pesë vetash, i kushton shtetit 15 mijë dinarë për familje. Pra, për shpërnguljen e tyre duhen, të paktën, 600 milionë dinarë. Shtoj kësaj edhe rreth 200 milionë dinarë që duhen për vendosjen e familjeve tona në vend të shqiptarëve të shpërngulur. Kjo llogaritet, pasi shqiptarët e shpërngulur do të lënë jo vetëm tokën, por edhe shtëpinë dhe veglat e punës. Kështu, jo vetëm që do të vendoset pjesa më e madhe e kolonistëve tanë në shtëpitë e shqiptarëve, por me një ndihmë të vogël në bagëti dhe ushqime, këta do të marrin vetëm nga ana ekonomike dhe do të bëhen të pavarur. Gjatë krijimit të kolonive të reja, aty ku e lyp nevoja, duhet të përdoret edhe forca ushtarake, ashtu siç është përdorur gjatë ndërtimit të Sremska Raqes dhe të rindërtimit të fshatrave të shkatërruara nga tërmeti në vitin 1931, në jug. Për këtë punë, t'i jepet ushtrisë e drejta dhe mundësia që me thirrjen e rezervistëve në stërvitje ose me zgjatjen e afatit të shërbimit ushtarak, të krijojë një lloj shërbimi të detyrueshëm pune për qëllime publike. Në marrëveshje me organizatat dhe shoqëritë e specializuara, duhen kërkuar rrugë më pak të kushtueshme për hapjen e tokave nga shkurret, tharjen e moçaleve dhe të tjera. Gjatë kolonizimit shteti mund t'u japë kolonistëve prona me kredi ose me para në dorë. Do të ketë mjaft nga ata që do të blejnë toka në vise të reja dhe që do të shesin tokat e tyre në vendlindje. Nga kjo shteti do të marrë një pjesë të mirë të pronave që ka dhënë. Toka mund t'i shitet vetëm atij që ka

ndërmend të vendoset atje përfundimisht. Toka e dhënë me kredi nuk duhet të jetë e shtrenjtë. Kamata duhet të jetë minimale, koha e shlyerjes së kredisë duhet të fillojë disa vjet pas vendosjes së kolonëve, domethënë, kur ata të jenë fuqizuar ekonomikisht. Të marra së bashku, shuma prej disa qindra milionë dinarësh, nuk është ndonjë shpenzim i madh për shtetin, në krahasim me përfitimin që ai do të ketë. Sigurimi i pikave nevralgjike në jug, me vendosjen e elementeve tanë nacionalë, kursejmë në rast lufte disa divizione. Duke vendosur disa dhjetëra mijë familje si kolonialistë nga krahinat tona pasive, sidomos nga Mali i Zi, lehtësohet kriza ekonomike në ato zona. Për një detyrë të tillë nacionale, strategjiko-ushtarke dhe ekonomike, shteti ka për detyrë të sakrifikojë disa qindra milionë dinarë. Në një kohë kur është në gjendje të shpenzojë miliarda dinarë për ndërtimin e rrugës ndërkombëtare nga Subotica deri në Caribrod, nga e cila duhet të kemi përfitime, ndoshta në të ardhmen e largët. Ai duhet dhe mund të gjejë dhe milionat e dinarëve për këtë problem madhor nacional, siç është shpërngulja e shqiptarëve. Kolonizimi gradual, ashtu si edhe në vende të tjera, nuk ka pasur sukses te ne. Kur pushteti shtetëror dëshiron të ndërhyjë në interes të elementit të vet kolonizues, në luftë për tokën, mund të ketë sukses vetëm nëse vepron brutalisht. Përndryshe, shqiptarët e rrënjësuar në vendlindje janë më të fortë se kolonisti. Kjo, në rastin tonë duhet pasur parasysh se kemi të bëjmë me një racë të varfër me rrënjë dhe pjellore. Për të, pat thënë Cvijiç se është më ekspansivja në Ballkan. Statistikat tregojnë se politikën tonë të kolonizimit e mundi pjelloria e grave shqiptare. Nga kjo duhet të nxjerrim përfundime dhe të korrigjohem, deri sa nuk është akoma vonë. E gjithë Evropa është në një gjendje kaotike. Ne nuk dimë se ç'na sjell dita e jo më nata. Nacionalizmi shqiptar, edhe në viset, tona po rritet".

(Nga elaborati i Vaso Çubriloviqit).